



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 905/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Xhavit Spahiu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Xhavit Spahiu, Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me shenjën ZL.Anr.905/2017 e datës 10.11.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.905/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Xhavit Spahiu, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, i cili pretendon se në ditën e votimit në ora 11:00, në VV 2115b/01R dhe VV 2115b/04D ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit.

Parashtruesja e apelit si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që janë paraqitur në ditën e votimit, ankesa është dashur të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është pranuar nga PZAP me datën 10.11.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.905/2017 të datës 10.11.2017, ndërlihet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar me datë 09.11.2017 në PZAP, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.905/2017 më datën 12.11.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.